



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot. \_\_\_\_\_

Tiranë, më \_\_\_\_ . . 2022

**V E N D I M**

**Nr. \_\_\_\_\_, Datë \_\_\_\_ . . 2022**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar <sup>1</sup>, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>2</sup> mori në shqyrtim ankesën me nr. 193 Regj., datë 28.10.2021, të subjektit ankues, M. K, kundër Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (AKBPM), me pretendimin e diskriminimit për “çdo shkak tjetër<sup>3</sup>”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Subjekti ankues, M. K ka qenë e punësuar pranë Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (në vijim cituar me akronimin AKBPM ose Agjencia) për periudhën nga data 13.05.2013 deri më datë 11.06.2021.

<sup>1</sup> Në vijim do t’i referohemi me akronimin LMD.

<sup>2</sup> Në vijim do t’i referohemi si Komisioneri, ose me akronimin KMD.

<sup>3</sup> Subjekti ankues referon tek ky shkak denoncimin që ajo ka bërë kundrejt paligjshmërive dhe veprimeve antiligjore në çënim të sigurisë së shëndetit publik dhe sigurisë kombëtare, të punëdhënësit/AKBPM.

Marrëdhënia juridike e punës midis palëve, ka qenë e formalizuar në Kontratën Individuale të Punës, me nr. 1307/3 prot., datë 13.05.2013, të lidhur midis Punëdhënësit/AKBPM dhe Punëmarrësit/M. K, fillimisht në detyrën “Analist” në Sektorin e Kontrollit të Vaksinave, e më pas “Analist” në Laboratorin e Kontrollit.

Me Urdhrin nr. 27, datë 29.03.2018 “Për disa lëvizje të personelit në AKBPM”, të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ankuesja është emëruar në detyrën “Shef i Laboratorit të Kontrollit” në Agjenci, detyrë të cilën e ka ushtruar deri në qershor të vitit 2021.

Subjekti ankues ka pretenduar diskriminim nga ana e AKBMP-së, lidhur me dy momente gjatë marrëdhënieve të saj të punës:

Pretendimi i parë lidhet me projektin “Strengthening Sound of Chemical and Pharmaceutical Waste Management in Albania”, projekt ky i ideuar dhe përgatitur nga ankuesja. Lidhur me këtë pretendim, ankuesja në parashtrimet e sjella pranë Komisionerit, ndër të tjera, shprehet se:

*“Në qershor të vitit 2017 kam aplikuar për fonde në UNEP për projektin “Strengthening Sound of Chemical and Pharmaceutical Waste Management in Albania”, projekt i ideuar dhe përgatitur për aplikim nga ana ime dhe caktuar nga ish-drejtori i AKBPM-së që ky projekt të përgatitej dhe drejtohej nga ana ime. Në janar të vitit 2019 nga UNEP-i në adresën time vjen përgjigjja e Bordit Ekzekutiv të Special Programme të UNEP, që projekti është aprovuar me financim të plotë në shumën 248.714 dollarë amerikan. UNEP e kishte si kusht paraprak që emri i drejtorit të projektit, të monitoruesit dhe audituesit të projektit të përcaktoheshin para se të dorëzohej projekt-propozimi, në rast të kundërt aplikimi nuk do të merrej në konsideratë.*

*Projekti u miratua me mua si drejtor projekti, por në mënyrë të paligjshme ky projekt u transferua nga AKBPM në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) dhe në projekt u përfshinë persona të cilët nuk kanë lidhje me projektin por kanë vetëm interesa personale. Unë që ideova dhe përgatita gjithçka, jo vetëm që nuk mu lejua të drejtoj projektin, por as të jem fare pjesë e tij. Megjithëse unë përgatita çdo gjë dhe bëra të mundur që në Shqipëri të fitohej një projekt nga UNEP, OKB, në momentin që projekti u fitua, projekti u përvetësua dhe unë u përjashtova në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Kodin e Punës.*

*Në korrik 2020 kam paraqitur pranë ILDKPI-së ankesë lidhur me procedurat në shkelje të Udhëzimit nr. 30/2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”. Nga ky sinjalizim, jo vetëm që shkelësit e ligjit nuk morën përgjegjësitë e tyre, por u ngritën në përgjegjësi”.*

Në vijim, në parashtrimet e depozituara pranë KMD-së, nëpërmjet shkresës me nr. 477 prot., datë 18.03.2022, ankuesja në prapësim të argumentave të sjella nga AKBPM (nëpërmjet shkresës me nr.6568/8 prot., datë 22.11.2021) ka ngritur disa pyetje, si më poshtë citojmë:

*“Pse pas shkresës sime në lidhje me projektin unë kam marrë masë disiplinore të cilën e faktojnë të gjitha shkresat? Në të gjitha fjalët e errëta të AKBPM besoj qëllimisht ka nuk ka vendosur një masë disiplinore që më është dhënë nga titullari, N. S në lidhje me “Urdhër i brendshëm” për*

*mbetjet farmaceutike dhe kimikatet në magazinën e AKBMP-së, e cila lidhet me projektin. AKBPM të sqarojë: Pse nuk e ka vendosur edhe këtë masë disiplinore në Janar 2019?*

*Kush është pika fokale e projektit, çfarë lidhje ka personi me projektin?*

*Çfarë lidhje ka N. S me projektin në fjalë?*

*Pra, gjithë lufta, shpifjet dhe intrigat e N. S ndaj meje ishin që të më merrte projektin, pasi OKB nuk lejonte që drejtori i Institucionit të ishte pjesë e projektit.*

*Çfarë lidhje kanë B. Xh, K. C, N.B, L.K, B. M me projektin në fjalë?*

*Kush është background-i i këtyre personave që J. B, N. S i shpërblen me punën, sakrificat dhe dijet e mija?”.*

Në vijim të këtyre parashtrimeve, ankuesja ka dërguar prapësime të tjera, nëpërmjet e-mailit datë 13.05.2022, ku, ndër të tjera, shprehet se:

*“Në shqyrtim të dokumentacionit të paraqitur nga AKBPM kam konstatuar një sërë problematikash, shkelje të cilat në mendimin tim mund të jenë: 1. Fallsifikim provash; 2. Fshehje e provave;*

*Institucionet e përmendura nga AKBPM (KLSH, ILDKPKI, Avokati i Popullit, Komisioneri për Informim, Platforma e Bashkëqeverisjes) sipas interpretimeve të bëra nga AKBPM dhe materialet e paraqitura prej tyre dalin të perfshira në:*

*a) Fshehjen e provave;*

*b) Institucionalizim i mashtrimit në AKBPM;*

*c) Shpërdorim detyre;*

*c) Shkelje e rëndë e sigurisë së barnave dhe për pasojë e shëndetit të popullatës;*

*d) Shkelje e sigurisë kombëtare”.*

*Pretendimi i dytë i ankueses lidhet me diskriminimin e saj gjatë marrëdhënieve të punës (masat disiplinore/vërejtjet me shkrim të dhëna kundrejt saj nga titullari i Institucionit ) dhe në zgjidhjen e marrëdhënieve të punës nga punëdhënësi/AKBPM (Urdhri me nr.65, datë 08.06.2021)*

Në muajin qershor 2021, ankuesja është larguar nga puna, dhe lidhur me këtë moment, për të cilin dhe ka pretenduar diskriminimin nga ana e ish-punëdhënësit, shprehet se ka ardhur si formë e hakmarrjes, për shkak të ankesave që ka bërë kundër drejtueses së AKBPM/punëdhënësit, për shkak të denoncimeve të paligjshmërive dhe veprimeve antiligjore të saj.

Në këtë kontekst, ankuesja ka pretenduar se largimi i saj nga puna nga ky i fundit, ka ardhur për shkak të ankesave për shkeljet dhe paligjshmëritë e punëdhënësit. Ajo e sheh largimin nga puna si veprim diskriminues dhe hakmarrës të drejtueses së AKBPM, vetëm për faktet e denoncuar prej saj.

Në përfundim, subjekti ankues ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi;

*“Të konstatohet diskriminimi nga ana e punëdhënësit, dëmi financiar i shkaktuar nga AKBPM, rikthimi në vendin e punës, si dhe drejtimi i projektit “Strengthening Sound of Chemical and Pharmaceutical Waste Management in Albania”, me gjithë dëmin financiar deri në marrjen e pozicionit të drejtorit të projektit”.*

## II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga LMD.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Nëpërmjet me nr. 1505/1 prot., datë 08.11.2021, Komisioneri ka njoftuar dhe i ka kërkuar parashtrime, Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore/AKBPM, lidhur me pretendimet e subjektit ankues.

- Nëpërmjet shkresës me nr. 6568/8 prot., datë 22.11.2021, AKBPM, ka njohur Komisionerin lidhur me qëndrimin e Institucionit, përsa i takon pretendimeve të ankueses, të cilat në konkluzion të tyre përmbledhin si më poshtë citohet:

*“Në gjykimin e punëdhënësit/AKBPM, mospërfundimi i procedurave të plota të inventarizimit të aktiveve të gjendura në Laboratorin e Kontrollit, mosrinisja e punës për të garantuar vendosjen në treg të barnave të sigurta, cilësore dhe efikase për popullatën si dhe pengesa e fillimit të procesit të*

akreditimit të laboratorit, kanë ardhur për shkak të mospërmbushjes së detyrave funksionale dhe moszbatimit të urdhrave të titullarit të Institucionit nga shefi laboratorit, M. K, për arsye të:

- Shmangies nga përgjegjësia për drejtimin dhe organizimin e grupeve të punës, në të cilat ka qenë pjesë;
- Shmangies nga detyrat e ngarkuara, duke krijuar situata/konflikte me vartësit, kolegët/shefat e sektorëve dhe eprorin;
- Mungesës së organizimit dhe menaxhimit të stafit në varësi.

Arsye këto të cilat përbëjnë mospërmbushje të detyrimeve kontraktore bazuar në nenin 11, nenin 11/1, 12, 21, 23/1, 24/1, 125, 141 e vijues, të Kodit të Punës, nga punëmarrësi në detyrën “Shef Laboratori i Kontrollit” në AKBPM, dhe akteve nënligjore që rregullojnë marrëdhënien e punës në RSh.

Në vlerësim të të gjitha gjetjeve, konstatimeve dhe përfundimeve të arritura nga Grupi i Punës (ngritur me UB nr. 31, datë 23.02.2021) në raport me gjendjen e faktit, mospërmbushjen e detyrimeve kontraktore nga punëmarrësi M. K, punëdhënësi pasi ka vlerësuar të gjitha këto rrethana të rënda, të cilat sipas parimit të mirëbesimit nuk lejojnë më vazhdimin e marrëdhënies së punës me punëmarrësin, ka zgjidhur kontratën e punës me M. K.

Në lidhje me problematikat në marrëdhënien juridike të punës me punëmarrësin M. K, të parashtruara më sipër, ju bëjmë me dije se:

Komunikimi i AKBPM-së me MSHMS, në cilësinë e Organit Epror ka qenë i vazhdueshëm, kjo për shkak të situatës në Laboratorin e Kontrollit, duke informuar mbi hapat proceduralë të ndërmarrë nga Agjencia.

Me aktin shkresor nr. 1026/10 prot., datë 10.06.2020, drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë, është përcjellë informacioni i plotë dhe i hollësishëm në lidhje me problematikat e ndeshura në veprimtarinë e Laboratorit të Kontrollit, si rezultat i mosorganizimit, moskoordinimit dhe keqmenaxhimit të Sektorit, i cili ishte nën përgjegjësinë e M. K, në cilësinë e Shefit të Laboratorit të Kontrollit.

Me aktin shkresor nr. 1026/11 prot., datë 24.06.2020, drejtuar MSHMS, me objekt “Propozim për rishikimin e marrëdhënieve juridike të punës me punëmarrësin M. K”, është përcjellë shqetësimi në lidhje me moskryerjen e inventarizimit nga punëmarrësi me funksione menaxheriale në zbatim të Urdhrit nr. 72, datë 06.05.2020, duke krijuar pengesa në vijimin e procesit të mobilimit dhe vendosjen në funksion të plotë të Laboratorit të Kontrollit, në ambientet e rikonstruara.

Me shkresën me nr. 934/3 prot., datë 22.07.2020, MSHMS, ka orientuar fillimin e procedurave disiplinore ndaj punëmarrësit si rezultat i mospërmbushjes së detyrimeve sipas kontratës dhe rregullores së brendshme të Institucionit, duke garantuar të drejtën e punëmarrësit, referuar përcaktimeve të Kodit të Punës.

*Sa më sipër, procedura administrative është pezulluar për shkak të ankesës së punëmarrësit M. K pranë ILDKPI-së, njoftuar me shkresën me nr. 2242/4 prot., datë 03.07.2020, dhe e vijuar në prill-maj të vitit 2021, si rezultat i moszbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, dhe urdhrave të titullarit të Institucionit për rinisjen e menjëhershme të punës në Laboratorin e Kontrollit”.*

Në parashtrimet e sjella pranë KMD-së, nga ana e AKBPM, ndër të tjera, është theksuar fakti se:

*“...angazhimi kryesor dhe i vetëm i punëmarrësit M. K, nga muaji mars i vitit 2019 e në vijim, ka qenë finalizimi i Marrëveshjes së Projektit të Bashkëpunimit me UNEP, i quajtur “Strengthening Sound Chemical & Pharmaceutical Waste Management in Albania” projekt ky i aplikuar në qershor 2017 në mënyrë individuale nga M. K, në cilësinë e Drejtorit të Projektit, por në emër dhe llogari të AKBPM-së, si Institucion zbatues i projektit për palën shqiptare (kundrejt një dokumenti “Letër mbështetje për projektin e propozuar” me datë 19.06.2017 e nënshkruar dhe vulosur nga ish-Drejtori i Agjencisë (pa numër protokollit), dhe për më tepër një projekt i aplikuar jashtë fushës së përgjegjësisë së Laboratorit të Kontrollit të Cilësisë së Barnave, apo dhe të vetë Agjencisë si organ ligjzbatues dhe pjesë e administratës shtetërore (VKM nr. 24. Datë 14.01.2015 “Për miratimin e Strukturës dhe Mënyrës së Funkcionimit e Oganizimit të Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore”, të ndryshuar.*

*Sa më sipër, nuk rezultonte proces i dokumentuar dhe administruar në protokoll-arkivin e Institucionit që nga muaji qershor 2017 (në kundërshtim të hapur me Normat Tekniko-Profesionale dhe Metodologjike të Shërbimit Arkivor në fuqi, në RSh), por është bërë prezent në Agjenci, me shkresën zyrtare me nr. 3272/1 prot., datë 20.06.2019, të Sekretarit të Përgjithshëm të MSHMS, me anë të së cilës përcillej “Kërkesa për miratim projekti” e M. K, të depozituar me datë 20.06.2019 pranë MSHMSH, si dhe dokumentacioni i dorëzuar prej saj.*

*Referuar dokumentacionit jemi bërë me dije se:*

*P. A, në detyrën “Drejtor i Përgjithshëm” në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave të Mjedisit/Ministria e Mjedisit, në cilësinë e pikës fokale të Programit Special të UNEP, përfaqësues zyrtar i palës shqiptare, kishte nënshkruar dhe vulosur (vula zyrtare e Ministrisë së Mjedisit) dokumentin “Vërtetim i Regjistrimit në emër dhe për llogari të Qeverisë Shqiptare”, të datës 19.07.2017 dhe M. K përfaqësues i autorizuar nga AKBPM për implementimin e projektit bazuar në “Letër mbështetje për projektin e propozuar” e datës 19.06.2017.*

*Nga shtatori 2019 e në vijim, u ndërmorën të gjitha hapat procedural dhe institucional për transferimin e projektit në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, si përfaqësues i Programit Special të UNEP, i cili disponon kapacitetet e nevojshme dhe strukturat përkatëse për ndjekjen e zbatimin e projekteve.*

*Në kushtet kur vetë legjislacioni në fuqi për mbrojtjen e mjedisit dhe menaxhimin e integruar të mbetjeve të rrezikshme, pjesë e të cilave janë edhe mbetjet farmaceutike, i adresojnë çështjet e menaxhimit të mbetjeve të rrezikshme tek Ministria e Mjedisit dhe Turizmit, dhe strukturat e*

*varësisë së tyre, nuk ka asnjë shkak ligjor që të kundërshtojë vendimmarrjen e përbashkët sipas së cilës institucioni ndjekës dhe zbatues i projektit “Strengthening Sound Chemical & Pharmaceutical Waste Management in Albania” të jetë Ministria e Mjedisit dhe Turizmit, sikurse dhe është aktualisht”.*

2. Mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të kësaj ankese, Komisioneri, nëpërmjet shkresës me nr. 121 prot., datë 17.01.2022, njoftoi dhe ftoi palët për pjesëmarrje në seancë dëgjimore. Seanca dëgjimore e planifikuar për t'u zhvilluar me datë 28.01.2022, për arsye objektive nuk mund të realizohej në këtë datë dhe iu komunikua palëve se ajo do të realizohej me datë 10.03.2022 (e-mail i KMD-së, datë 27.01.2022).

Seanca e njoftuar u zhvillua me datë 10.03.2022, në ambjentet e Zyrës së KMD-së, në prani të subjektit ankues dhe përfaqësuesit të saj ligjor, av. S. G.

Pala kundër së cilës ankuesja ka paraqitur ankimimin e saj, AKBPM, nuk u paraqit pasi nëpërmjet e-mailit datë 10.03.2022 ka njoftuar Komisionerin se:

*“Në vijim të komunikimit në lidhje me seancën dëgjimore të ditës së sotme në orën 12:00, në respekt të institucionit tuaj do e vlerësonim shumë pjesëmarrjen po për shkaqet që ju kemi bërë me dije mendojmë që çdo gjë do jetë pjesë e debatit gjyqësor që dhe ai është i vështirë për shkak të objektit- marrëdhënie pune.*

*Në lidhje me informacionin dhe dokumentacionin e plotë të përcjellë pranë jush në Nëntor të vitit 2021 në faqen 21 të materialit jemi shprehur për faktin se me ankuesen jemi në proces gjyqësor sipas njoftimit të bërë nga gjykata, ku citohet si vijon:*

*Pika 7) aktualisht, Ankuesi/Paditësi M. K i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes civile me objekt:*

*1. Konstatimin e zgjidhjes së menjëhershme dhe pa shkaqe të justifikuara të marrëdhënies së punës.*

*2. Detyrimin e palës së paditur t'i paguajë paditëses: 3(tre) paga mujore dëmshpërblim për shkak të moszbatimit të afatit të njoftimit (shkelje e nenit 143/1, 155/1 të K.Punës); 2(dy) paga mujore dëmshpërblim për shkak të moszbatimit nga punëdhënësi të procedurës së njoftimit për largimin nga puna (shkelje e nenit 144 të K.Punës); 4(katër) paga mujore shpërblim për vjetërsi në punë (neni 145 i K.Punës); 12 (dymbëdhjetë) paga mujore dëmshpërblim për shkak të largimit në mënyrë të menjëhershme dhe pa shkaqe të justifikuara nga puna (neni 153/3 dhe 155/3 të K.Punës);*

*Çështja rezulton e hyrë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me Nr.Regjistrimi Akti 15024/2021, datë 02.09.2021, me gjyqtar E. B, bashkëlidhur Deklarata e Mbrojtjes me Nr.Prot.6568/3, datë 27.10.2021 të Palës së Paditur –AKBPM, në lidhje me çështjen civile që do të shqyrtohet pranë gjykatës, kërkesë-padia dhe aktet e tjera të njoftuara me Deftesë Komunikimi nga gjykata."*

*Nuk kemi parashtrime shtesë apo dokumentacion shkresor nga ai që është depozituar më herët pranë jush”.*

Pala ankuese u njoh me parashtrimet e AKBPM-së dhe iu bë e ditur se në vijim mund të depozitonin parashtrime dhe dokumentacion shtesë, nëse do të kishin.

Komisioneri ka administruar dhe vlerësuar gjatë shqyrtimit të kësaj çështjeje, pretendimet e të dyja palëve, argumentat e dokumentacionin e depozituar prej tyre lidhur me problematikat e ngritura.

### **III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

#### **A.1 Lidhur me pretendimin e subjektit ankues, për trajtim të padrejtë e të pafavorshëm nga ana e AKBPM-së, përsa i takon kalimit për zbatim të projektit “*Strengthening Sound Chemical & Pharmaceutical Waste Management in Albania*”, nga AKBPM tek Ministria e Mjedisit dhe Turizmit.**

*Nga këqyrja e dokumentacionit dhe kronologjia e ngjarjeve dhe fakteve rezulton se:*

Nëpërmjet shkresës me nr. 3272/1 prot., datë 20.06.2019, M. K i është drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) me kërkesën me lëndë: “Kërkesë për miratimin e projektit “*Strengthening Sound Chemical & Pharmaceutical Waste Management in Albania*”.

Nga përmbajtja e shkresës sipërcituar, evidendohet se, në qershor 2017, M. K në mënyrë individuale, ka aplikuar në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, në programin Special Programe në Gjenevë, për projektin “*Strengthening Sound Chemical & Pharmaceutical Waste Management in Albania*”, (në cilësinë e drejtorit të proektit) në emër dhe për llogari të institucionit të AKBPM, si institucion zbatues i projektit për palën shqiptare. Ky projekt, në mbledhjen e datës 29-31 janar 2019, të organeve të UNEP, është shpallur fitues.

Në shkresë citohet fakti se, AKBPM është institucion i përfshirë në skemën e menaxhimit të mbetjeve farmaceutike dhe se, projekti do të bëjë një vlerësim të situatës për menaxhimin e mbetjeve farmaceutike dhe kimike në Shqipëri.

Në shkresë theksohet gjithashtu fakti, se, në këtë projekt është e rëndësishme edhe përgatitja e praktikave më të mira për menaxhimin e mbetjeve, forcimit të kapaciteteve në vend dhe rritjen e ndërgjegjësimit me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës dhe mjedisit.

Subjekti ankues, znj. K, informon MSHMS se, projekti është aprovuar nga Sekretariati i Special Programe, UNEP Gjenevë dhe njëherësh kërkon nga Ministria, miratimin për vazhdimësinë e projektit.



Nëpërmjet shkresës me nr. 3272/2 prot., datë 21.06.2019, MSHMS, i drejtohet AKBPM, duke e informuar se pranë institucionit të kësaj ministrie është paraqitur kërkesa për miratimin e projektit sipërcituar, dhe ka kërkuar nga AKBPM marrjen e masave të nevojshme për implementimin dhe zbatimin e tij.

Bashkëlidhur shkresës janë depozituar disa letra mbështetjeje për këtë projekt nga ana e Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, e titullarit të AKBPM, Inspektoratit Shtetëror të Shëndetësisë (ISHSHS), Drejtorisë së Kujdesit Shëndetësor (DKSH), Ministrisë së Mjedisit (MM), të cilat datojnë të gjitha në qershor 2017, periudhë kur u aplikua për projektin në fjalë.

Gjithashtu, referuar dokumentacionit bashkëlidhur shkresës sipërcituar, rezulton se P. A, në detyrën e Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave të Mjedisit në Ministrinë e Mjedisit, në cilësinë e pikës fokale të Programit Specila të UNEP, përfaqësues zyrtar i palës shqiptare, kishte nënshkruar dokumentin “Vërtetim i Regjistrimit në emër dhe për llogari të qeverisë shqiptare”, të datës 19.06.2017 dhe znj. K përfaqësues i autorizuar nga AKBPM për implementimin e projektit bazuar në “Letër mbështetjeje për projektin e propozuar”, të datës 19.06.2017.

Referuar sa më lart, AKBPM është vënë në dijeni të projektit objekt shqyrtimi, vetëm në datën 21.06.2019, nëpërmjet shkresës së MSHMS.

Vetë MSHMS, në përgjigje të ankesës së znj. K drejtuar platformës “Shqipëria që duam”, me nr. 160643, lidhur me shqetësimin e saj për implementimin e projektit në fjalë, mbështetet në argumentimin dhe dokumentacionin e përmendur nga AKBPM, duke cituar shprehimisht se:

*“Institucioni i AKBPM është vënë në dijeni të projektit në fjalë në darën 24.06.2019, nga shkresa e MSHMS. Që pas marrjes dijeni të këtij fakti, nëpërmjet shkresës me nr. 4344/1 prot., datë 09.07.2019 me objekt “Kërkesë për informacion dhe vënie në dispozicion dokumentacioni” i kemi kërkuar znj. K të gjithë informacionin në lidhje me procedurat e ndjekura nga institucionet shtetërore të përfshira në projekt, dokumentat shkresore, aplikimin zyrtar në UNEP, komunikimet me përfaqësuesit e tyre, problematikat, rekomandimet, diskutimet, ndryshimet në drafte të propozuara nga AKBPM, kronologjinë e procesit që çoi në miratimin e aplikimit dhe të gjitha korrespondencat që Shefja e Laboratorit, në cilësinë e personit të autorizuar nga ish-titullari i AKBPM ka ndjekur çdo veprim deri në fitimin e projektit.*

.....

*Në vijim, bazuar në informacionin që dispononim bëmë një analizë të projektit dhe kemi patur një komunikim të vazhdueshëm zyrtar me Sekretarin e Përgjithshëm të MTM, konkretisht nëpërmjet shkresës me nr. 4344/5 prot., datë 19.07.2019, ku jemi shprehur se, nga analizimi i projektit, ai konsiston kryesisht në trajnime e work-shope. Ky projekt ka për qëllim vlerësimin e situatës për menaxhimin e mbetjeve farmaceutike e kimike në Shqipëri duke evidentuar problemet që hasen, synon të bëjë ndërhyrje efektive për zgjidhjen e tyre dhe të propozojë ndryshime të legjisllacionit për mbetjet, që është fushë e veprimtarisë së MTM. Gjithashtu ka si synim përgatitjen e praktikave të*

*shëndosha për menaxhimin e mbetjeve kimike/farmaceutike, forcimin e kapaciteteve dhe rritjen e ndërgjegjësimit për mbrojtjen e shëndetit dhe mjedisit. Ndërsa, fusha e veprimtarisë së AKBPM-së bazohet në shërbimin farmaceutik, e specializuar në analizën e barnave, inspektimin e tregut farmaceutik, dhënien e autorizimit për trgtim, studimin e efekteve anësore të barnave, administrimin e standardeve të pajisjeve mjekesore”.*

Përsa i përket menaxhimit të mbetjeve kimike/farmaceutike, Agjencia mendon që institucioni implementues të jetë MTM për arsye të fushës që mbulon, çështjeve të mbetjeve dhe si hartuese e ligjeve për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit nga mbetjet kimike/farmaceutike, adresuar edhe nga projekti.

Në përgjigje të AKBPM mbi projektin në fjalë, MTM, nëpërmjet shkresës me nr. 6833/1 prot., datë 27.08.2019, ka sqaruar se, ecuria e vazhdimësia e këtij projekti nën drejtimin e MTM, kërkon paraprakisht miratimin nga donatori i projektit, dhe se pas marrjes së dakordësisë, duhet të dërgonin informacionin e duhur mbi projektin në adresën zyrtare [X.X@turizmi.gov.al](mailto:X.X@turizmi.gov.al)

Bazuar në kërkesën e MTM, në kronologji kohore evidentohen hapat e mëtejshëm nga AKBPM, lidhur me transferimin e projektit tek MTM. Kështu, me shkresën me nr. 4344/13 prot., datë 10.09.2019, AKBPM i është drejtuar UNEP-it një kërkesë me objekt “Mbi një ndryshim në lidhje me zbatimin e projektit “Strengthening Sound Chemical & Pharmaceutical Waste Management in Albania”, (projekti # 515.2), duke kërkuar vlerësimin e mundësisë së zhvendosjes së institucionit implementues, i cili do ti hapë rrugën Marrëveshjes së Re të Bashkëpunimit midis UNEP dhe MTM, dhe zbatimit të projektit nga AKBPM tek MTM, si institucioni që merret që merret me çështje të administrimit të mbetjeve dhe hartimit të legjislacionit përkatës për mjedisin dhe mbrojtjen e shëndetit nga mbetjet kimike/farmaceutike.

UNEP-i ka kthyer përgjigje në rrugë elektronike AKBPM, (email i cili është protokolluar me nr. 4344/16 prot., datë 25.09.2019 pranë AKBPM), duke aprovuar kalimin e projektit tek MTM dhe duke kërkuar t’i viheshin në dispozicion kontaktet me institucionin e ri implementues.

Nëpërmjet shkresës me nr. 4344/17 prot., datë 01.10.2019, AKBPM i ka përcjellë MTM emailin e UNEP, në mëyrë që prej tyre të vijohej me hapat e mëtejshëm të zbatimit të projektit.

Nga komunikimet e mëvonshme (referuar shkresës datë 13.12.2019 të UNEP drejtuar AKBPM dhe shkresës me nr. 4344/23 prot., datë 22.01.2020 të AKBPM drejtuar UNEP) mes UNEP dhe AKBPM, evidentohet se, ka patur një mosrakordim midis Sekretariatit dhe Bordit Ekzekutiv të UNEP, lidhur me kërkesën e AKBPM për transferimin e projektit nga Agjencia tek MTM.

Pas komunikimeve shkresore të shkëmbyera ndërmjet UNEP, AKBPM dhe MTM, konstatohet se me datë 25.09.2020, ndërmjet MTM dhe AKBPM, është nënshkruar Memorandumi i Bashkëpunimit (shkresa me nr. 6643 prot., datë 25.09.2020), lidhur me implementimin e zbatimit e projektit në fjalë<sup>4</sup>.

---

<sup>4</sup> [http://www.mjedisi.gov.al/wp-content/uploads/2020/07/Dokumenti-i-Politikave-Strategjike\\_AL.pdf](http://www.mjedisi.gov.al/wp-content/uploads/2020/07/Dokumenti-i-Politikave-Strategjike_AL.pdf)

Nga këqyrja e akteve të disponuara në dosjen e KMD-së lidhur me çështjen në fjalë, evidentohet se ankuesja, që pas datës 20.06.2019, datë në të cilën ka kërkuar pranë MSHMS miratimin e projektit “Strengthening Sound Chemical & Pharmaceutical Waste Management in Albania”, ka kërkuar në mënyrë të vazhdueshme informacion lidhur me vijimësinë e masat e ndërmarra nga ana e AKBPM, duke qenë se ajo ishte caktuar dhe drejtore e këtij projekti, përse i takon implementimit e zbatimit të tij nga institucioni i AKBPM.

Nga komunikimet e shpeshta me e-mail apo dhe në rrugë shkresore, kryesisht gjatë vitit 2020 dhe 2021<sup>5</sup>, deri në momentin e zgjidhjes së marrëdhënies së punës me ankuesen nga AKBPM, konstatohet se ndërmjet palëve (*ankueses/punëmarrësja-N. S/ punëdhënësi*) ka gjeneruar një debat e konflikt i hapur lidhur me pretendimet e tyre. Respektivisht:

- Të ankueses kundrejt punëdhënësit lidhur me faktin se projekti duhet të implementohej e zbatohet nga institucioni që kishte aplikuar e i cili ishte miratuar nga UNEP për zbatimin e tij, nga AKBPM dhe jo t’i transferohej MTM, dhe nga ajo personalisht, si personi i cili kishte ideuar e punuar për fitimin e këtij projekti në emër të institucionit.
- Të punëdhënësit kundrejt ankueses lidhur me faktin se ajo kishte aplikuar e fituar këtë projekt, në emër të institucionit të AKBPM dhe jo si person individualisht e shkëputur nga Institucioni. Lidhur me faktin se ajo kishte aplikuar nëpërmjet adresës së saj personale të e-mailit, dhe jo asaj zyrtare të Institucionit, me qëllim fshehjen e transparencës lidhur me projektin. Fakt, të cilin AKBPM e evidenton kur thekson se ankuesja nuk ka njoftuar lidhur me hapat e procedurën e ndjekur lidhur me aplikimin e fitimin e projektit, deri në momentin që ata janë vënë në dijeni nga MSHMS, me date 24.06.2019.
- Të punëdhënësit lidhur me faktin, se ndryshe nga vetë ankuesja dhe ish-titullari i mëparshëm i AKBPM, kanë vlerësuar se institucioni që ka tagrin e kompetencën për implementimin e zbatimin e projektit është MTM dhe jo AKBPM.

Konflikti mes palëve, ankueses dhe punëdhënësit ka agravuar me dhënien e masave disiplinore kundrejt saj, me datë 04.05.2020, datë 25.05.2021 dhe me datë 08.06.2021, masa të cilat respektivisht janë kundërshtuar gjyqësisht nga ankuesja, dhe aktualisht ndodhen në proces gjyqësor.

- Komisioneri ka konstatuar se pikërisht, konflikti i krijuar mes ankueses dhe punëdhënësit të saj, për shkak të mosmarrëveshjes e debateve të lindura, pas miratimit nga ana e UNEP, për zbatim të projektit nga ana e AKBPM, ka ndodhur pas momentit që punëdhënësi ka ardhur në dijeni të këtij fakti, pra, me datë 24.06.2019 (pasi ishte informuar nëpërmjet shkresës së MSHMS, të datës 21.06.2019).
- Ankuesja ka pretenduar diskriminim të saj nga ana e AKBPM për shkak të denoncimit që ajo ka bërë në institucionet kompetente, kundrejt paligjshmërive dhe veprimeve antiligjore në cënim të sigurisë së shëndetit publik dhe sigurisë kombëtare, të punëdhënëses së saj, drejtueses së AKBPM.

---

<sup>5</sup> Referuar akteve të depozituara në dosjen e ankueses.

Këto denoncime ankuesja faktohet t'i ketë paraqitur, kronologjikisht:

- Pranë ILDKPI, nëpërmjet kërkesës me datë 26.06.2020.
- ILDKPI, nëpërmjet shkresës me nr. 2242/4 prot., datë 03.07.2020 ka njoftuar AKBPM lidhur me pranimin e sinjalizimit të M. K. Në përfundim të hetimit administrative të sinjalizimit të jashtëm mbi “Shkelje të procedurave ligjore për inventarizimin e akteve në përdorim në AKBPM dhe dhënie masash disiplinore të pabazuara në ligj”, ILDKPI ka njoftuar Kontrollin e Lartë të Shtetit (KLSH), me qëllim verifikimin dhe auditimin e pretendimeve të ngritura lidhur me sa më sipër. (KLSH ka miratuar Vendimin nr.9, datë 29.01.2021 “Për auditimin tematik të ushtruar në AKBPM “Auditim përputhshmërie”, për periudhën 01.11.2019-31.08.2020).
- Drejtuar Ministres së MSHMS (*e-mail i datës 02.06.2021*) duke e informuar lidhur me veprimet e paligjshme në kuadër të projektit “Strengthening Sound Chemical & Pharmaceutical Waste Management in Albania”, si dhe masat disiplinore të dhëna kundrejt saj në shenjë hakmarrjeje nga ana e AKBPM, për shkak të denoncimeve të bëra nga ajo, lidhur me abuzimet e Agjencisë.
- Pranë Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje, me datë 18.06.2021, me objekt “Shkelje dhe abuzime në AKBPM”.
- Po me datë 18.06.2021, ankuesja i është drejtuar edhe Kryeministrit, nëpërmjet një kërkesë për informacion, me lëndë “Shkelje dhe abuzime në AKBPM”. Në shkresë ankuesja evidenton faktin se nga ana e AKBPM janë bërë shkelje për interesa të një grupi të caktuar personash, duke bërë të pamundur realizimin e misionit të saj për barna të sigurta për popullatën dhe duke cënuar sigurinë kombëtare. Ankuesja njëherësh ka informuar Kryeministrin edhe përsa i takon pretendimit të saj për ndërhyrje të padrejtë e shkelje ligjore të titullares së AKBPM në projektin “Strengthening Sound Chemical & Pharmaceutical Waste Management in Albania”, dhe transferimin e tij tek MTM, si dhe për masat disiplinore të ndërmarra kundrejt saj për shkak të denoncimit të këtyre shkeljeve nga AKBPM, si dhe për shkak se ankuesja nuk ka lejuar të abuzohet me shëndetin e popullit shqiptar.

Pra, për sa më lart, bazuar në kronologjinë kohore të denoncimeve të bëra nga subjekti ankues kundrejt paligjshmërive të pretenduara të AKBPM në organet kompetente respektive, rezulton se, ato janë bërë pasi AKBPM ka vendosur të transferojë për implementim e zbatim projektin “Strengthening Sound Chemical & Pharmaceutical Waste Management in Albania”, nga AKBPM tek MTM.

Në këtë kontekst, Komisioneri vlerëson se, pretendimi i ankueses për diskriminim nga AKBPM, lidhur me heqjen e të drejtës për zbatimin e projektit nga AKBPM dhe kalimin e tij tek MTM, për shkak të denoncimit të saj për shkelje ligjore nga AKBPM (*klasifikuar tek “çdo shkak tjetër”*), nuk qëndron dhe është i pabazuar, pasi ka ndodhur më përpara në kohë se ankimimet/denoncimet e saj. (*ankesat e ankueses i korrespondojnë në kohë datave të mëvonshme, pra pasi projekti ishte propozuar nga AKBPM për transferimin e tij tek MTM*).

Në këtë kontekst, ky shkak i pretenduar i ankueses mund të qëndrojë lidhur me pasojat që asaj i kanë ardhur si shkak i këtyre denoncimeve, pra lidhur me masat disiplinore të ndërmarra kundrejt saj nga ana e AKBPM, por jo lidhur me transferimin e projektit tek MTM, i cili rezulton se është transferuar para se ajo të ankohej lidhur me shkeljet e pretenduara (*përfshirë edhe ankesat e saj për shkeljet e AKBPM lidhur me projektin në fjalë*).

Ankuesja ka pretenduar gjithashtu se në raport me veprimet kundrejt saj:<sup>6</sup> *“AKBPM ka shpërdoruar detyrën, fshehur provat, shkelur rëndë sigurinë e barnave me pasojë shëndetin e popullatës, shkelur rëndë sigurinë kombëtare, si dhe ka institucionalizuar mashtrimin”*.

Lidhur me këto pretendime të ankueses, Komisioneri vëren se, hetimi i tyre nuk bën pjesë në kompetencën e KMD-së. Pra, për sa më sipër është organi i Prokurorisë, organi kompetent që ushtron ndjekjen penale.<sup>7</sup>

Neni 1, dhe 1/b, i Kodit Penal, përcakton se: *“Ligji penal përcakton veprat penale, dënimet dhe masat e tjera që merren ndaj autorëve të tyre. Veprat penale ndahen në krime dhe në kundravajtje penale. Legjislacioni penal i Republikës së Shqipërisë ka për detyrë të mbrojë pavarësinë e shtetit dhe tërësinë e territorit të tij, dinjitetin e njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, rendin kushtetues, pronën, mjedisin, bashkëjetesën dhe mirëkuptimin e shqiptarëve me pakicat kombëtare, si dhe bashkëjetesën fetare nga veprat penale, si dhe parandalimin e tyre”*.

Neni 186<sup>8</sup>, i Kodit Penal, përcakton se: *“Falsifikimi ose përdorimi i dokumenteve të falsifikuara dënohet me burgim deri në tre vjet.*

*Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunimi ose më shumë se një herë apo ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në katër vjet.*

*Kur falsifikimi bëhet nga personi që ka për detyrë të lëshojë dokumentin, dënohet me burgim nga një vit deri në shtatë vjet”*.

Neni 248<sup>9</sup>, i po këtij Kodi, përcakton se: *“Kryerja ose moskryerja me dashje e veprimeve a e mosveprimeve në kundërshtim me ligjin, që përbën mospërmbyllje të rregullt të detyrës, nga personi që ushtron funksione publike, kur i kanë sjellë atij ose personave të tjerë përfitime materiale ose jomateriale të padrejta a kanë dëmtuar interesat e ligjshëm të shtetit, të shtetasve dhe të personave të tjerë juridikë, nëse nuk përbën vepër tjetër penale, dënohet me burgim deri në shtatë vjet”*.

Kodi i Procedurës Penale, në nenet 277 e 278 të tij, ka parashikuar organet kompetente që ushtrojnë ndjekjen penale dhe që shprehen e disponojnë lidhur me të, shprehimisht: *“Prokurori dhe policia gjyqësore zhvillojnë, brenda kompetencave të caktuara, hetimet e nevojshme që lidhen me ushtrimin e ndjekjes penale.*

---

<sup>6</sup> E-mail i ankueses dërguar KMD-së me datë 13.05.2022. (referuar gjithashtu, shkresës me nr. 477 prot., datë 18.03.2022 pranw KMD-së).

<sup>7</sup> Neni 148, i Kushtetutës së Shqipërisë shpreh se: *“Prokuroria ushtron ndjekjen penale....”*

<sup>8</sup> Falsifikimi i dokumenteve.

<sup>9</sup> Shpërdorim i detyrës.

*Prokurori drejton hetimet dhe ka në dispozicion policinë gjyqësore.*

*Gjatë hetimeve paraprake, për rastet e parashikuara nga ligji, mbi kërkesën e prokurorit, të pandehurit, viktimës dhe palëve private, vendos gjykata.*

*Kërkesat e palëve gjatë hetimeve paraprake, sipas paragrafit 1 të këtij neni, shqyrtohen nga i njëjti gjyqtar”.*

Për sa më sipër, subjekti ankues mund t'i denoncojë këto fakte pranë organeve kompetente që kanë tagrin për t'i hetuar e vlerësuar ato.

Komisioneri ka gjykuar mbi bazën e akteve shkresore të sjella nga pala, AKBPM, i cili është person juridik, institucion shtetëror dhe mban përgjegjësi ligjore lidhur me vërtetësinë e akteve të sjella prej tyre në cilësi prove. Në të kundërt, nëse ankuesja ka dyshime apo prova e fakte lidhur me manipulimin, falsifikimin, mashtrimin e për më tepër cënimin e sigurisë kombëtare përsa i takon cënimit të shëndetit të popullatës, nga ana e AKBPM, ka detyrimin qytetar e ligjor t'i denoncojë pranë organeve kompetente për shqyrtimin e tyre.

Për të vërtetuar faktin se ankuesja është ekspozuar ndaj një sjellje diskriminuese nga ana e AKBPM, duhet të ekzistojë një lidhje objektive shkakësore ndërmjet shkakut të mbrojtur nga ligji 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar dhe trajtimit të padrejtë të ankueses.

Mbështetur në deklaratimet, faktet dhe provat e depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, Komisioneri, ka vlerësuar se, pavarësisht konstatimit apo jo të trajtimit të padrejtë të ankueses lidhur me pretendimin lidhur me projektin në fjalë, ankuesja nuk arriti të provojë dhe dokumentojë se shkak i pretenduar prej saj ka shërbyer si shkak për të cilin ajo është diskriminuar nga ana e punëdhënësit/Agjencisë.

Në këtë kontekst, faktet dhe provat e administruara janë të pamjaftueshme për të krijuar prezumimin se kjo sjellje të cilës i është nënshtruar ankuesja lidhur me pretendimet për projektin në fjalë, është si rezultat i posedimit të këtij shkak, për sa kohë punëdhënësi veprimet e tij në kuadër të kalimit të projektit tek MTM, dokumentohen se janë bërë para denoncimeve të ankueses për shkelje ligjore e abuzime të drejtores së AKBPM.

Komisioneri vlerëson se, ankuesja nuk arriti të provojë dhe dokumentojë se shkak i pretenduar prej saj ka shërbyer si shkak për të cilin ajo është diskriminuar nga ana e punëdhënësit/Agjencisë, përsa i takon heqjes së saj si drejtores e projektit në fjalë dhe kalimit të tij për zbatim tek MTM.

Komisioneri vlerëson se, në kushtet kur, bazuar në faktet dhe provat e administruara nuk mund të prezumohet se diskriminimi ka ndodhur, AKBPM, nuk mund të ngarkohet me detyrimin për të provuar se trajtimi i padrejtë dhe më pak i favorshëm të cilit i është nënshtruar ankuesja nuk përbën diskriminim.

Sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se ankesa e paraqitur nga subjekti ankues, me pretendimin për diskriminim lidhur me projektin në fjalë, *për shkakun e analizuar më sipër*, nga ana e punëdhënësit/AKBPM është e pabazuar, pasi *nuk rezultoi i provuar vetë shkakun e pretenduar.*

Për rrjedhojë, nuk rezulton që, lidhur me këtë pretendim të jenë shkelur dispozitat e ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

**A. 2 Lidhur me pretendimin e subjektit ankues, për trajtim të padrejtë e të pafavorshëm nga ana e AKBPM-së, përsa i takon masave disiplinore të dhëna nga punëdhënësi/AKBPM, gjatë marrëdhënieve të punës, si dhe zgjidhjes përfundimtare të marrëdhënies së punës me të.**

*Nga këqyrja e dokumentacionit të depozituar pranë KMD-së, nga palët në proces, rezulton se:*

- Nëpërmjet Vendimit “Mbi kryerjen e veprimeve paraprake dhe caktimin e seancës përgatitore”, me nr. Regj. Themeltar 9176, datë 11.06.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, evidentohet se ankuesja M. K, ka paraqitur kërkesë padi pranë kësaj gjykate, kundër palës AKBPM, në objekt të së cilës ka kërkuar shfuqizimin e aktit administrativ, Urdhër i Brendshëm nr. 64, datë 04.05.2020 “Vërejtje me shkrim”.

Në parashtrimet e paraqitura pranë gjykatës, ankuesja, ndër të tjera, citon se:

*“.....Kam kërkuar nga AKBPM heqjen e masës disiplinore “Vërejtje me shkrim”, si të pamotivuar e të pajustificuar, pasi nuk rezulton të kem fyer njeri a të kem shkelur etikën.*

*Motivacioni i formuluar më ka çënuar personalitetin dhe më ka shkaktuar një dëm të konsiderueshëm moral. Në ankesën drejtuar strukturave përgjegjëse janë parashtruar paligjshmëritë e konstatuara në procedurat e dhënies së masës disiplinore, si: Konventa e OKB-së mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit kundër grave, Konventa e Këshillit të Evropës “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”, Konventa Evropiane për të Drejtat Themelore të Njeriut (neni 14), Kushtetuta e Shqipërisë (neni 15, 18), etj.*

*Nëpërmjet shkresës me nr. 4344/37 prot., datë 06.05.2020, pala paditëse është vënë në dijeni të Urdhrit të Brendshëm me nr. 64, për dhënie të masës disiplinore “Vërejtje me shkrim”, me motivacionin: “Për shkelje të rëndë të rregullave të etikës në administratën shtetërore, ardhur si rezultat i mosrespektimit të autoritetit të Drejtorit të AKBPM-së dhe sjellje jo etike me kolegët”. Kjo vërejtje është kundërshtuar nga paditësja pasi në asnjë moment nuk ka shkelur detyrimet kontraktuale apo ligjin për etikën, pasi veprimtarinë e saj e ka ushtruar brenda kuadrit ligjor që rregullon marrëdhëniet e punës....ka kryer me përgjegjshmëri e profesionalizëm detyrat e ngarkuara dhe në mënyrë të vazhdueshme ka punuar për rritjen e nivelit profesional...Dëshmi e këtyre cilësive janë dhe kualifikimet e shumta të kryera si dhe vlerësimet e strukturave apo organizatave, si brenda dhe jashtë vendit. Pjesë e këtij vlerësimi është gjithashtu edhe grada shkencore “Doktor i Shkencave”, titulli si eksperte ndërkombëtare dhe angazhimi si eksperte në ekspertiza ndërkombëtare, por edhe pëzgjedhja si drejtuese projekti. Për këtë projekt UNEP (Seksion i OKB-së) ka shprehur miratimin si drejtuese e projektit, pa të cilin projekti nuk merrej në konsideratë.*

*Paditësja në mënyrë të vazhdueshme ka kërkuar nga pala e paditur, AKBPM, sqarime dhe ndërmarrjen e hapave konkretë mbi ecurinë e projektit.*

*Si kundërpërgjigje, më datë 30.04.2020, në mënyrë të papritur, jashtë ambjenteve të institucionit, paditësja është fyer e kërcënuar nga kolegu F. R, ngjarje për të cilën ajo ka bërë edhe kallëzim në Komisaratin nr.4 Tiranë, nga ndjekja e të cilit ka hequr dorë, pasi kolegu i ka kërkuar ndjesë për veprimin e kryer.*

*Drejtori e AKBPM ka njoftuar paditësen për takimet e datave 04.05.2020 dhe 05.05.2020, ku do të diskutohej në lidhje me kërkesat që ajo kishte paraqitur mbi projektin, dhe në të dy takimet diskutimi u zhvendos rreth konfliktit me kolegun F. R. Të nesërmen e takimit jam vënë në dijeni të Urdhrit të Brendshëm nr. 64, datë 06.05.2020, masë disiplinore “Vërejtje me shkrim”.*

*...Masa disiplinore e ndërmarrë nga Institucioni ndaj paditëses dhe qëndrimi që është mbajtur ndaj punonjësit për fyerjet e kërcënimet që ai i ka bërë koleges janë të pajustificuara, bien në kundërshtim me legjislacionin vendas dhe KEDNJ-në. Këto qëndrime i kanë shkaktuar paditëses vuajtje shpirtërore e dëm moral, i kanë cënuar personalitetin, të drejtat e interesat e ligjshme, qetësinë shpirtërore e familjare, si dhe marrëdhëniet që kanë të bëjnë me cilësinë e jetës së saj, të drejta këto të mbrojtura nga rendi juridik. Ekziston një lidhje shkakësore juridike mes fakteve të paligjshme dhe cënimeve të shëndetit që ka pësuar paditësja”.*

- Në kërkesë padinë e ankueses, të depozituar me datë 02.09.2021 pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kundër AKBPM-së, me objekt, ndër të tjera, konstatimin e zgjidhjes së menjëhershme dhe pa shkaqe të justifikuara të marrëdhënies së punës nga ana e AKBPM-së, (referuar Urdhrit të Brendshëm me nr. 5950/34, datë 08.06.2021, të AKBPM, “Largim nga detyra për M. K”) evidentohet se, pretendimet e saj lidhur me punëdhënësin, përsa i takon marrëdhënies kontraktuale dhe detyrimeve të palëve po i ndjek gjyqësisht dhe i ka bërë pjesë të kërtimeve të saj para gjykatës.

*Refreruar akteve në dispozicion të KMD-së, konstatohet se motivacioni që i ka shërbyer AKBPM për zgjidhjen e menjëhershme të marrëdhënies së punës për shkaqe të justifikuara me ankuesen ishte, për: “Shkelje të rëndë të detyrave që rrjedhin nga marrëdhënia juridike e punës, nga ana e punëmarrësit, në cilësinë “Shefi i Laboratorit të Kontrollit”, përgjegjës për organizimin, drejtimin, menaxhimin dhe kontrollin e veprimtarisë së Laboratorit të Kontrollit, si dhe raportimin para Drejtorit të Agjencisë të të gjithë veprimtarisë dhe aktiviteteve të sektorit, të ardhura si rezultat i moszbatimit dhe mosrespektimit në mënyrë të përsëritur të urdhrave dhe udhëzimeve të përgjithshme dhe të veçanta të punëdhënësit”.*

*Ankuesja në parashtrimet e saj para gjykatës, ndër të tjera, ka cituar se: “Kërkoj nga gjykata, vlerësimin sa më objektiv të situatë së prodhuar në mënyrë artificiale nga ana e punëdhënësit, situatë e cila në paligjshmëri të plotë, është finalizuar me marrjen e masës disiplinore ekstreme ndaj meje.*



.....Përsa i përket arsyeve dhe shkaqeve të përmendura në Urdhrin objekt gjykimi, dua të sjell në vëmendjen e gjykatës se shumica e tyre, janë pretendime të cilat janë pasuar nga marrja e masave disiplinore të mëparshme dhe që në kohën e nxjerrjes së këtij Urdhri, i janë nënshtruar shqyrtimit gjyqësor. Për rrjedhojë, asnjë prej tyre nuk mund të shërbejë si alibi për nxjerrjen e urdhrin objekt ankimim dhe interpretimi apo kundërshtimi i tyre, i takon tashmë një tjetër procesi gjyqësor.

Në lidhje me pretendimin për mosrindisjen e punës dhe moskryerjen e kontrollit të barnave, sqarohet se, Laboratori që të vihej në punë duhej të kryeshin më parë procedurat e përcaktuara nga vlerësimi i bërë nga specialistët e aparaturave, shërbime dhe kalibrime, për të plotësuar kushtet teknike të funksionimit të tyre.

Në lidhje me pretendimin e punëdhënësit se nga ana ime nuk janë përgatitur informacionet e hollësishme në lidhje me rekomandimet e Auditit të Përputhshmërisë së KLSH-së, ju bëj me dije se në asnjë moment nuk më është vënë në dispozicion materiali i këtij audit, as nga KLSH, as nga ILDKPI, e as nga AKBPM. Madje dua të theksoj se pa patur një qëndrim zyrtar të Institucionit, unë përsëri nuk do të mund të veproja, pasi sikurse dihet, objekt i veprimtarisë së KLSH, është konstatimi i shkeljeve dhe dhënia e rekomandimeve përkatëse për rregullimin e situatës së konstatuar. Në këto kushte, kur nuk ka një qëndrim zyrtar të institucionit (ose të paktën unë nuk jam në dijeni) në lidhje me këto rekomandime, është e pamundur dhe në tejkalim të kompetencave që unë t'i trajtoj ato si të mirëqena.

Në përmbyllje të rrethanave, fakteve dhe shkeljeve të kryera nga ana e Drejtores së AKBPM gjatë procedurës së zgjidhjes së marrëdhënies së punës, dua të sjell në vëmendje të gjykatës edhe faktin se të gjitha faktet e pretenduara kundër meje, janë fabrikuar nga i padituri brenda një kohe të shkurtër, fakt i cili tregon nxitimin për krijimin e terrenit të përshtatshëm për të më larguar nga puna..”.

Bazuar në sa më sipër, çështja e paligjshmërisë të pretenduar nga ankuesja kundrejt AKBPM-së në cilësinë e ish-punëdhënësit, lidhur me detyrimet ligjore të shkelura e të parespektuara gjatë marrëdhënies së punës, është në proces shqyrtimi e vlerësimi pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Komisioneri vlerëson se, për të konstatuar nëse ka patur apo jo nga ish-punëdhënësit/AKBPM sjellje apo veprime diskriminuese kundrejt ankueses, paraprakisht duhet konstatuar paligjshmëria e AKBPM lidhur me sa më sipër (masat disiplinore të dhëna ndaj ankueses), dhe pastaj duhet hetuar e gjykuar nëse shkaku i pretenduar nga ankuesja lidhet me këtë paligjshmëri të pretenduar. Mirëpo, pretendimet e ankueses për paligjshmëri të veprimeve të AKBPM gjatë marrëdhënies së punës dhe në zgjidhjen përfundimtare të saj janë bërë objekt i shqyrtimit gjyqësor.

Në këtë kontekst, juridiksioni gjyqësor është i ndarë nga ai administrativ, por aktet e këtij të fundit janë objekt kontrolli nga gjykata administrative, e cila vendos përfundimisht për çështjen.

Në rastin e ankueses, të njëjtat fakte e rrethana (lidhur me kundërshtimin e masave disiplinore të dhëna kundrejt saj, përfshirë dhe masën ekstreme të largimit nga puna, nga ana e AKBPM) janë

bërë objekt shqyrtimi si në juridiksionin administrativ, ashtu dhe atë gjyqësor. Në këto kushte, konform nenit 36, paragrafi 3, i Kodit të Procedurës Civile, prevalon shqyrtimi dhe vendimmarrja e këtij të fundit.

Përsa më sipër, në kushtet që kjo çështje është duke u gjykuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, si dhe në mbështetje të nenit 66, pika 1, të Kodit të Procedurës Administrative, ku parashikohet: “...Nëse organi publik që zhvillon procedurën përballet me një çështje, zgjidhja e së cilës është parakusht për zgjidhjen e procedurës dhe që përbën një çështje ligjore të pavarur, për zgjidhjen e së cilës është kompetent një gjykatë ose organ tjetër (“çështja paraprake”), organi publik që zhvillon procedurën administrative pezullon procedurën deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë për çështjen paraprake dhe njofton palën në lidhje me këtë”.

Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi pezullon shqyrtimin e ankesës nr. 193 Regj., datë 28.10.2021, të M. K, lidhur me pretendimin për diskriminim për zgjidhjen e marrëdhënies së punës nga AKBPM, deri në momentin që Gjykata të shprehet me vendim të formës së prerë.

#### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenin 66, pika 1 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, mbështetur në nenin 1, nenin 7, pika 1, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, shkronja a), e nenin 33, pikat 10-11, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

#### **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të subjektit ankues M. K nga ana e Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (AKBPM), lidhur me pretendimet për projektin “*Strengthening Sound Chemical & Pharmaceutical Waste Management in Albania*”, dhe transferimin e tij tek Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM).
2. Pezullimin e shqyrtimit të ankesës me nr. 193, datë 28.10.2021, të subjektit ankues M. K<sup>10</sup>, lidhur me masat disiplinore dhe zgjidhjen e marrëdhënies së punës nga ana e AKBPM, deri në momentin që Gjykata e Apelit Tiranë, të shprehet për çështjen në shqyrtim.

---

<sup>10</sup> Lidhur me pretendimin e subjektit ankues, për diskriminim nga ana e AKBPM-së, përsa i takon masave disiplinore të dhëna ndaj tij nga punëdhënësi/AKBPM, gjatë marrëdhënies së punës, si dhe zgjidhjes përfundimtare të marrëdhënies së punës me të.

3. Detyrimin e palëve në proces, që në përfundim të shqyrtimi të kësaj çështjeje pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, të njoftojnë Komisionerin lidhur me vendimmarrjen e saj, si dhe depozitimin e një kopjeje të vendimit përkatës.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja e tij.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**

Fusha: Punësim  
Shkaku: Çdo shkak tjetër  
Lloji i vendimit: Pezullim